



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” ADMINISTRATORI

Drejtoria e Prokurimeve dhe Shërbimeve në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel administrativ, **Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve**

Personeli administrativ: **Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve** në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve: *përgjigjet për mbarëvajtjen e punës në sektorin e prokurimit duke koordinuar punën midis specialistëve të sektorit dhe drejtorinë; u jep zgjidhje ligjore dhe teknike problemeve brenda sektorit duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë; zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat për ndjekjen e problemeve duke bashkëvepruar me drejtorin e drejtorisë; raporton tek drejtori, harton raporte, kryen analiza periodike si dhe me përpikmëri e nivel të lartë përgjegjshmërie brenda afateve detyrat që i ngarkohen,*

Kandidati duhet të plotësojë kritere të përgjithshme e të veçanta për këtë pozicion pune.

### **Kritere të përgjithshme:**

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i shkencave) ose diplomë ekuivalente me të në shkenca juridike. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

### **Kritere të veçanta:**

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) ose ekuivalente me të, në shkenca juridike.
- Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite pune në profesion.
- Të ketë kryer trajnime apo kualifikime në fushën e prokurimit publik
- Njohës i programeve bazë kompjuterike
- Të ketë njohuri të mira të një gjuhe të huaj perëndimore.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Protokollin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**28.12.2021 - 10.01.2022**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
ADMINISTRATORI**

- Letër motivimi për pozicionin e punës *Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve* në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Referenca pune nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë.
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (28.12.2021 - 10.01.2022) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyta”,  
Aplikim për pozicionin e punës: *Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve*  
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc brenda periudhës (11.01.2022 – 30.01.2022), do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.